

**VENDIM**  
**Nr. 452, datë 22.5.2013**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 575, DATË 28.5.2009 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË  
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË  
PËRDORIM TË KOMUNËS REMAS TË QARKUT TË FIERIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 8/b të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Revokimin e kalimit të së drejtës së pronësisë, me vendimin nr. 575, datë 28.5.2009 të Këshillit të Ministrave, komunës Remas të qarkut të Fierit, për pronat me numër rendor 1 deri 182, sipas listës së inventarit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, komuna Remas dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**